



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KRYEMINISTRI

**U R D H Ë R**

Nr. 192, datë 31.7.2014

**P Ë R**

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS  
PËR VLERËSIMIN E DËMIT TË PËSUAR NGA VIKTIMAT  
E 21 JANARIT 2011**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

**U R D H Ë R O J:**

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për marrjen e masave për vlerësimin e dëmit të pësuar nga viktimat e ngjarjes së 21 janarit të vitit 2011, si pasojë e veprimeve të Gardës së Republikës. Për efekt të këtij urdhri, konsiderohen viktima të ngjarjeve të 21 janarit 2011 të ndjerët Faik Myrtaj, Ziver Veizi, Hekuran Deda dhe Aleks Nika.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga z. Artur Metani, zëvendëssekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
  - Z. Genci Gjonçaj, sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
  - Znj. Geraldina Prodani, sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave;
  - Znj. Llambriola Misto, sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
  - Znj. Alma Hicka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit;
  - Një përfaqësues nga Garda e Republikës;
  - Një ekspert i sigurimeve, i caktuar nga Ministria e Financave.